

**URDHËR**  
**Nr. 561, datë 23.12.2021**

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19,  
PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS PUBLIKE, PUNONJËSIT E  
SUPERMARKETEVE DHE QENDRAVE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 18, pika 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimeve të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4881, datë 2.12.2021 dhe nr. 5180, datë 23.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

**URDHËROJ:**

1. Punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe të qendrave tregtare, si një ndër kategoritë që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, me qëllim për të penguar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga Sars-Cov-2 (COVID-19), duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës, duke filluar nga data 4.1.2022, një nga dokumentet e mëposhtme:

a) certifikatë vaksinimi COVID-19, të lëshuar nga *e-Albania*, që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar;

b) test PCR-je, çdo 5 ditë, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2;

c) certifikatë shërimi COVID-19 të lëshuar nga *e-Albania* ose dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit, që provon shërimin nga infeksioni Sars-Cov-2, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.

2. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

3. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e administratës publike dhe subjektet private që ushtrojnë aktivitet tregtar në supermarkete apo qendra tregtare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**